

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“URBAN GASTRONOMY ALBANIA”**

Sot më datë 16 . 01 .2024, u paraqitën palët e mëposhtme:

Besmir Lulaj, lindur në Tiranë, më 13.12.1990, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër J01213080A.

Aleksandër Naci, lindur në Vrisera, më 01.06.1984, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër I406011150.

Ata kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, ky Akt Themelimi dhe Statuti.

**NENI 1
EMËRTIMI**

Themeluesi do të ndërtojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta quajë “Urban Gastronomy Albania” SHPK. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**NENI 2
SELIA**

Selia e Shoqërisë do të jetë në: *Tiranë, Sauk, Rruga “Hamdi Garunja”, Nd. 1, Ap. 2, ZK. 3266*. Me vendim të ortakëve mund të hapen seli sekondare, filiale ose forma të tjera shoqërishe, ashtu sikundër do t’a shohë të nevojshme shoqëria, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: hapjen e bar-bufëve, restoranteve, pikave të servisit, parkim automatësh, lavazhit të hoteleve, fshatrave turistike, moteleve si dhe agjencive për shitblerje, dhënie me qira të pasurive të tundshme e të patundshme agjencive për shitblerje, dhënie me qira të pasurive të tundshme e të patundshme, agjencive komisionere, transport të udhëtarëve e të mallrave si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Prodhimin dhe shitjen e çdo materiali të nevojshëm për zhvillimin e aktivitetit të saj kryesor; blerjen e ndërtesave dhe të drejtave për përdorim tokë ose të drejtave të pronësisë mbi tokën, ndërtim, rinovim dhe rikonstruksionin e ndërtesave dhe strukturave të tjera si edhe kryerjen e ndryshimeve strukturore, shtesave dhe



përmirësimeve mbi to sipas nevojës; dhënien me qira, dhënien me nën qira, hipotekimin, peng dhënien, shitjen, transferimin e cedimin si edhe mënyrat e tjera të disponimit të ndërtesave ose një pjesë të tyre, ose të drejtave personale dhe reale mbi tokën apo ndërtesat brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë. Çdo aktivitet tjetër ndihmës të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit të saj kryesor shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, të bieje dhe shesë ose marrë me qira pasuri të paluajtshme, ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, por pa u kufizuar në to si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelimin e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

NENI 5 KAPITALI

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000.000 (dhjetë milion) Lek.

5.2 Kapitali themeltar përbëhet nga 2 (dy) kuota.

NENI 6 KONTRIBUTET

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Z. Besmir Lulaj ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 5.100.000 (pesëmilionenjëqindmijë) Lek.
- Z. Aleksandër Naci ka ofruar një kontribut në para të barabartë me 4.900.000 (katërmilionenëntëqindmijë) Lek.


6.2 Sipas kontributit të mësipërm:

- Z. Besmir Lulaj do të mbajë 1 (një) kuotë e cila përfaqëson 51% (pesëdhjetëenjëpërqind) e kapitali të shoqërisë.
- Z. Aleksandër Naci do të mbajë 1 (një) kuotë e cila përfaqëson 49% (dyzetënëntëpërqind) e kapitali të shoqërisë.

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

NENI 8 NDRYSHIMET



Për detyrimet që krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të saj, kjo shoqëri përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi më pasurinë e tyre që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

NENI 9 ADMINISTRATORËT

9.1 Shoqëria përbëhet nga të paktën 1 (një) administrator dhe maksimumi 2 (dy) administratorë që qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen, për një periudhë maksimale prej 5 vitesh.

9.2 Përfaqësimi ligjor i shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat sipas nenit 95 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare".

9.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për akte të vecanta ose kategori aktesh.

9.4 Administrator i shoqërisë me themelimin e saj do të jetë personi si më poshtë: Z. Besmir Lulaj, lindur në Tiranë, më 13.12.1990, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit më Nr. Personal J01213080A, me mandat 5 vjecar.

NENI 10 GJUHA

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

Palët e gjejnë këtë Akt Themelimi në përputhje me vullnetin e tyre të plotë dhe e nënshkruajnë atë sipas ligjit.

THEMELUESIT

Z. BESMIR LULAJ

Besmir Lulaj



Z. ALEKSANDËR NACI

Aleksander Naci

